



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranverorë

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 07
Prishtinë, më 03 prill 2012, në orën 13:30 sala N-225
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Afrim Hoti, Adem Grabovci dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: z.Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, z.Bedri Hamza -ministër-Ministria e Financave, z. Ruzhdi Halili- Zyra për Planifikim Strategjik/ZKM.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatorë, Mehmet Simnica-zyrtar i fushës për ekonomi, Artan Venhari dhe Albert Krasniqi- KIPRED, Butrint Ymeri - praktikant.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 20.03.2012,
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Programin për Investime Publike(PIP)
4. Të Ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 20.03.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 20.03.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Programin për Investime Publike(PIP)

Kryetari – Sipas raportit të auditorit Komiteti për Investime Publike – i përbërë nga MF, Zyra për Planifikim Strategjik i ZKM-së dhe përfaqësuesit e OB-ve pjesëmarrëse ka për obligim që të shqyrtoj projektet kapitale mbi shumën prej 1 milion euro. Ky Komitet nuk ka arritur të shqyrtoj të gjitha projektet kapitale mbi shumën 1 milion euro sipas mandatit të tij.

Auditimi ka identifikuar mangësi në procesin e planifikimit strategjik të Qeverisë. Pastaj sistemi i PIP-it nuk është duke u përdorur në mënyrë të plotë dhe të saktë nga ana e të gjitha OB-ve. Për tu arritur kjo, sipas auditorit sistemi ka nevojë të ri-dizajnohet. Ka gabime në raportet e gjeneruara nga sistemi i PIP-it, ka mangësi në modulën e monitorimit të projekteve kapitale në raportet e gjeneruara nga sistemi i PIP-it, në nivelin komunal nuk ka ndarje në mes projekteve kapitale të reja dhe atyre që janë në vazhdim nga vitet paraprake. Sistemet FreeBalance, PIP dhe BDMS janë në ndërrarësi me njëri-tjetrin sa i përket këmbimit të informatave dhe ka nevojë për përmirësim në mënyrë që të jenë plotësisht funksional. Sipas Auditorit Komunitat nuk kanë arritur që të vendosin në Sistemin për Menaxhimin e Zhvillimit të Buxhetit në mënyrë të plotë informatat edhe pse kjo kërkohet. Ka mungesë të analizës së Kosto-përfitimeve për projektet në shumën mbi 400 mijë euro siç kërkohet. Nuk janë vendosur të gjitha informatat në PIP për sa i përket transferove të ndodhura kapitali nga një projekt në tjetrin, kjo për arsye se gjatë vitit fiskal ka shumë lëvizje të buxhetit kapital. Sipas Auditorit, sistemi i PIP-it lejon hyrjen në Obligime për projekte pa fonde të mjaftueshme. Kërkoj përgjigje lidhur me këto të gjetura.

Bedri Hamza, Ministër, MF- Lidhur me Raportin e ZAP-it tha se është për tu vlerësuar sepse është raporti i parë i këtij sistemi. Ka vend për të përmirësuar sistemin, por ka vend edhe për tu përmirësuar raportet e ZAP-it, si në cilësi edhe në të gjitha elementet që i përmban ky raport. Po flasim për një sistem të teknologjisë informative, zhvillimet në teknologjinë informative janë aq të hovshme, kështu që nuk mund të thuhet që një sistem që ka qenë adekuat para dy viteve. PIP është një sistem i cili është zhvilluar me përkrahjen dhe mbështetjen e KE-së. Në kohën kur është hartuar ky raport, procesi buxhetor ka qenë në zhvillim e sipër, dhe deri në përfundimin e këtij procesi kanë mundur të ndodhin ndryshime dhe raporti të mos e paraqet realitetin ashtu siç është. Komentet e ministrit është dashur të merren në konsideratë, në mënyrë që raporti të jetë një pasqyrim real i gjendjes. Për here të parë është përgatitur raporti për progresin fizik dhe financiar për projektet që ishin pjesë e buxhetit për vitin 2011 në fillim të këtij viti. Nga ky vit, këto raporte bëhen në baza 3 mujore. Sot nuk mund të xhindet asnjë projekt për vitin 2012, që nuk është pjesë e PIP-it. Ligji për buxhetin vetëm në 2 momente lejon ndryshimin apo plotësimin e tabelës 3.2 që ka të bëjë me buxhetimin kapital. Neni 7 i Ligjit të buxhetit, lejon mundësinë që OB-të të kryejnë obligimet e vitit paraprak nga projektet e reja ose nga ato që ende nuk kanë obligime. Pra edhe mbas datës 31 dhjetor, mbas aprovimit të buxhetit, lejohet që të ndryshohet apo plotësohet. Gjithashtu, Neni 13, pika 3, e lejon ministrin që në 3 mujorin e fundit të transferoj deri në 5% të vlerës totale të gjitha ndarjeve buxhetore mes kategorive ekonomike dhe OB-ve ku ka në shpenzim nga OB-të sipas rrjedhjes së parasë të dorëzuar në Thesar. Prandaj, ndryshimet e ndodhura edhe në vitin 2012, kanë ndodhur pikërisht në këto të drejta që i lejon Ligji i buxhetit për vitin 2011. Rastet individuale, fatkeqësisht janë dhënë përmbledhjet sikur të ishin raste të përgjithshme.

Roli i Zyrës për Planifikim Strategjik – MF-ja dhe ZPS –ja duhet të jenë të përfshira në mënyrë që strategjia të jetë e bërë për funksionim me të mire të sistemit të PIP-it. Gjatë kompletimit të kornizës ligjore, relevante për të mundësuar funksionimin e planifikimit strategjik dhe për të siguruar konsistencë në tërë procesin e planifikimit buxhetor, propozohet një planifikim strategjik që përcakton prioritetet e tij për projektet afatgjata.

Rekomandimin nr.1 - ZPS është themeluar në vitin 2010. Tani kjo zyre është duke u kompletuar dhe natyrisht, duke marrë përgjegjësitë e saja. Kjo zyre ka përgjegjësinë e përgatitjes së deklaratave të prioriteteve të Qeverisë, në nivel të politikave sektoriale dhe nder-

sektoriale. Me tutje, këto prioritete zhvillohen përmes kornizës afat-mesme të shpenzimeve me objektiva specifike, të matshme, dhe në fund, përmes procesit buxhetor, këto prioritete dhe objektiva operacionalizohen përmes projekteve dhe aktiviteteve individuale. Duket së ky kuptim i hapur nuk është kuptuar drejtë nga ZAP, sepse ZPS nuk merret me projekte individuale, por për projektet individuale dhe aktivitetet e paraqitura në procesin buxhetor, tregojnë së si duhet të arrihen objektivat me kornizën afat-mesme të shpenzimeve, dhe prioritetet e paraqitura në deklaratën e prioriteteve të Qeverisë. Në fakt, sistemi i PIP-it ka një procedure parësore që i kërkon çdo OB-je çka të tregojë, çdo projekt si përmbush objektivat dhe prioritetet e Qeverisë. Përshkrimi i dizajnit të procesit dhe sistemit, pra diskutimit të rekomandimeve, një nga një, është e rëndësishme të theksohet së auditimi nga ZAP është bërë në muajin Nëntor 2011, d.m.th shume pak kohe para së buxheti të dorëzohet në Kuvend për aprovim final. Disa punë zhvillimore për vitin 2011 ishin akoma në proces. Në atë kohe, disa nga rekomandimet e ZAP-it mund të ishin implementuar, ose ishin në proces të zhvillimit në kohen e auditimit.

Rekomandimi 2.1 - sistemi i PIP-it në përgatitjen e buxhetit për vitin 2011, është përdorur nga të gjitha OB-të. Kjo shihet nga Ligji i miratuar i buxhetit për vitin 2012, dhe është diçka që veçse ka filluar të implementohet tërësisht.

Rekomandimi 2.2 - mund të jetë i ndërlidhur me çështjet e ekzekutimit në Thesar, në ndërkohë është bërë rregullimi i ekzekutimit sipas projekteve individuale në Thesar, ashtu siç është paraqitur në tabelën 3.2 të buxhetit për vitin 2011.

Rekomandimi 2.3 - sistemi mund të prodhojë raporte për projektet mbi çfarëdo vlere, jo vetëm mbi 1 milion. Tani për tani sistemi është i programuar që të gjeneroj raporte për të gjitha projektet me vlere 400,000 dhe me të mëdha, kjo do të përfshinte edhe projektet që e kalojnë vlerën 1 milion. Raportet mbi projektet mbi 400,000 apo me shume janë bërë si pjesë e një marrëveshje të arritur me BB-në dhe FMN-në. Nuk ka asnjë arsye që të llogarisim një raport të veçantë për projektet mbi 1 milion. Një gjë e tillë nuk është e kërkuar as me ligj.

Rekomandimi 2.4 - kjo gjë behet posa të pranohen të dhënat e FreeBalanc-it nga Thesari në baza mujore, dhe bartën në sistem të PIP-it. Kjo edhe tani funksionon.

Rekomandimi 2.5 - ky projekt mund të rrjedh si rezultat që OB-të nuk e kuptojnë tërësisht progresin financiar për projektet shume vjeçare. Kjo do të thotë që ata financiarisht e mbyllin projektin për vitin aktual, dhe nuk e marrin parasysh që ky projekt vazhdon edhe në vitet e ardhshme. Me një fjale, ky është vetëm gabim teknik i prezantuar nga OB-të.

Rekomandimi 2.6 - ky veçse është në implementim. Ndërlidhja e sistemit të PIP-it me sistemet tjera. Ky seksion shpjegon saktësisht evolucionin dhe rritjen e përdorimit të PIP-it dhe BDMS-së.

Rekomandimi 3.1 - Kjo gjë aktualisht është duke u implementuar.

Rekomandimi 3.2 - ndërlidhja e sistemeve në mënyrë automatike është diçka që mund të ndodhe në të ardhmen, kur të krijohen kapacitetet humane dhe mundësitë buxhetore. Kërkesa e MF ka qenë që përveç këtyre sistemeve, në këtë sistem të integrohet edhe tash ASIKUDO, që është në implementim e sipër në Dogana, SITAKSI, që ka defekte në funksionimin e tij, ka nevojë që ose të ndërrohet me ndonjë sistem ose të ngritët niveli i tij, dhe gjithë këto të kenë një ndërlidhje mes vetë.

Planifikimi i procesit buxhetor dhe vendosja e informative në përputhje me PIP-in, ne kemi parasysh sugjerimet e auditorit, të para datës 30 prill, së para datës 30 prill, MF duhet të lëshojë një ose dy qarkore, që përcaktojnë tavan dhe çështje buxhetore përkatëse. MF-ja mendon ndryshe nga ZAP-i, sa i përket kësaj çështje, përderisa ligji i amandamentuar mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, lejon kornizën afatmesme të shpenzimeve të përfundoje me 30 prill. Prandaj, disa udhëzime duhet të lëshojë para kësaj date. Neni 20, pika 3 e Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, cakton datën për qarkoren e parë buxhetore, jo me vonë së data 15 maj. Do të thotë, janë afat që janë të përcaktuara me ligj. Aspektet e buxhetimit nga lart-poshtë, referencat të cilat i përdorë ZAP-i, për të sqaruar shifrat e vlerësuar të shumave për projektet kapitale duke marrë për bazë KASH-in dhe qarkoret buxhetore nuk tregojnë jo-konsistencën e planifikimit buxhetor. Këta numra janë rezultat që kanë

përcjell ndryshimet në indikatorët makro-fiskal që buxheti është dashur t'i përcjell. *Rekomandimi 4.1* -çështja e kornizës afat-mesme të shpenzimeve, qarkoreve buxhetore, nuk kanë të bëjnë me sistemin e PIP-it. ZPS nuk ka të beje me sistemin e PIP-it. Të dhënat në projektet e testuara janë të lidhura me prioritetet e sektorëve. Siç është cekur në raportin e auditimit, personali është trajnuar për përdorimin e sistemit PIP. Megjithatë, fakti që OB-të nuk kanë treguar lidhje në mes të emrit të projektit dhe prioritetëve të sektorit, nuk do të thotë që automatikisht siç thekson auditori “*së këto mos-përputhje tregojnë së projektet e zgjedhura dhe të prezantuara në sistem nuk janë në konsistence me prioritetet e Qeverisë*”. Në fakt në një raport të përfunduar të kohëve të fundit është përcaktuar përmbajtja e projekteve në vitin 2012. Buxheti qendror për 492 milion, tërësisht 84.4% ka qenë brenda njërës, nga 4 programet zhvillimore të Qeverisë. Për më tepër së 70% të projekteve kanë qenë të lidhura drejtpërdrejtë me prioritetet e Qeverisë për vitin 2012-2014.

Rekomandimi 4.2 – nuk mund të pritet që të gjitha projektet e dorëzuara të jenë me informacion të plota. Sepse buxheti nuk është vetëm një dokument profesional, por është edhe një dokument politik, që nganjëherë në momentin e fundit në komisione ka zhvendosje prej projekteve në projekte.

Pavarësisht trajnimeve dhe pavarësisht kërkesave që fusha të caktuara në sistemin e PIP-it duhet të plotësohen, në të kundërtën sistemi nuk do të pranojë projektin, kjo megjithatë ndodh. MF-ja po vazhdon të kërkojë mënyra për të siguruar që OB-të të plotësojnë në mënyrë kualitative të dhënat e nevojshme dhe një mekanizëm të zbatueshëm dhe të duhur që MF-ja mund të përdorë, për të siguruar që kërkesat buxhetore nuk do të pranohen pa informacione të plota.

Rekomandimi 4.3 – OB-të janë të thirrura që projektet kapitale t'i përgatisin në harmoni me objektivat dhe prioritetet e tyre sektoriale. MF-ja në këtë rast mund vetëm të ndihmojë ministritë e linjës me shembuj konkret që mund të ekzistojnë një ndërlidhje e projekteve me prioritetet sektoriale.

Rekomandimi 4.4- Është nën përgjegjësinë e OB-ve që të përkujdesen që kontratat e lidhura për projekte të natyrës së tillë, të lidhen në harmoni me ndarjen dhe vlerësimet buxhetore, në rast që ndodh që kontratat e nënshkruara të jenë me të larta se ndarjet dhe vlerësimet buxhetore, MF-ja rekomandon OB-të që në fillim të rregullojnë ndarjet buxhetore për të mbuluar obligimet e mbetura, Neni 7 i Ligjit të buxhetit për vitin 2011.

Rekomandimi 4.5 - sistemi i PIP-it ka zhvilluar analizën kost-benefit. Janë mbajtur disa trajnime dhe disa pritët të mbahen gjatë këtij viti. Shpresojmë që për përgatitjen e buxhetit për vitin 2013, kjo analizë do të përdoret për projekte të reja të cilat janë mbi limitin mbi 1 milion euro, në fazën e parë.

Rekomandimi 4.6 - KIP në baze të nevojave dhe analizave të tij, mund të vendosë së në deri çfarë shume dhe cilat projekte kapitale do t'i ekzaminojë për të dhënë rekomandime ministrit të financave për përmirësimin e menaxhimit të projekteve kapitale. Mbi bazën e këtyre rekomandimeve, ministri mund të ndërmarrë masa për kursime mbi projekteve të caktuara të cilat nuk realizohen sipas dinamikës së planifikuar apo fillojnë të realizohen në kohën e paraparë. Këto kursime për aq sa e lejon Ligji i buxhetit, mund të përdoren për projekte që kanë dinamike me të shpejtë të realizimit apo për qëllime tjera që përsëri janë brenda Ligjit të buxhetit.

Rekomandimi 5.1. - një procedure ka filluar në fillimit të vitit dhe që rezultoi me një raport mbi progresin financiar dhe fizik për të gjitha projektet me të mëdha së 400,000 euro, deri me 31 dhjetor 2011. Ky raport është kompletuar në fund të shkurtit-fillim të marsit 2012. Për më tepër, një shabllon dhe mekanizëm janë venë në përdorim për raportet e rregulla 3 mujore për projektet e madhësisë së ngjashme. OB-të u janë siguruar trajnime dhe udhëzime, ndërsa me shume trajnime do t'i ofrohen personelit të MF-it. Raportimi i rregullt do të fillojë në prill.

Rekomandimi 5.2 - kjo veçse është duke ndodhur.

Rekomandimi 5.3 - kjo është përgjegjësi e OB-ve dhe i nënshtrohet shqyrtimit nga ana e MF-it. Konstatimi i fundit është së buxheti i vitit 2011 me angazhimin shtesë të analistëve është rregulluar.

Rekomandimi 5.4 - këto ndryshime kanë ndodhur brenda Ligjit të buxhetit, Nenit 14, Ligjit MFPP dhe Neni 30, pika 2.

Rekomandimi 5.5. - Raportet për monitorimin e buxhetit mbi 10,000 euro prodhohen dhe monitorohen nga departamenti i Thesarit. Këto raporte kërkohen në mbështetje të nenit 15 të Ligjit të buxhetit. ZAP-it i është bërë me dije se këto raporte nuk kërkohen nga departamenti I buxhetit dhe nuk prodhohen nga ky departament. Si duket edhe në këtë rast si dhe në disa raste të tjera, Auditori nuk ka marre parasysh sqarimet dhe rekomandimet e MF-it.

Rekomandimi 5.6 - Transferet në sistemin e PIP-it teknikisht mund të realizohen në vitin 2012, duke e evidentuar edhe datën, por me qëllim të sigurimit që ky sistem tani është funksional, deri në përfundim të vitit do të përdoret edhe paralelisht edhe sistemi aktual i transfereve. Përdorimi i PIP-it, raportimi i informatave përmes PIP-it, MF duhet të sigurojë veprime konkrete për të ngritur cilësinë dhe mirëmbajtjen e PIP-it, për të mundësuar raportim të plotë të informatave dhe azhurnim të raportit në modulën përkatës. Sistemi aktual i PIP-it modifikohet dhe përdoret sipas nevojave dhe kapaciteteve humane. Jo në çdo rast raporti që mund të prodhojë sistemi i PIP-it është i nevojshëm, sepse procesi buxhetor nuk është proces statik, por është procesi dinamik që evoluon sipas nevojave të reja.

Rekomandimi 6.2 – OB-të duhet t'i kushtojnë me shumë vëmendje vlerësimeve dhe përgatitjeve për kërkesa për projekte kapitale. Për këtë qëllim, është duke u trajnuar stafi nëpër ministritë e linjës për çdo vit buxhetor dhe gjithmonë ky proces duhet të vazhdojë. *Rekomandimi i fundit* – MF-ja pajtohet se kontrollet e arsyeshme janë të domosdoshme për të siguruar që buxheti kapital zhvillohet dhe mbështetet në qëllimet e Qeverisë. Kjo është një përgjegjësi e përbashkët e MF-it dhe të gjitha OB-ve në nivel qendror dhe lokal. Dhe për fund, ka qenë një projekt i mbështetur i KE-së. Ka mundur të mos jetë sistemi i PIP-it, por ka mundur të jetë një sistem tjetër. Disa prej rekomandimeve veç janë implementuar, disa janë në implementim, dhe disa kanë qenë të tejkaluara, por koha kur është bërë raporti, procesi i buxhetit ka qenë në zhvillim e sipër.

Lars Lage OLOFSSON –Konkluzioni i përgjithshëm i ZAP-it në lidhje me këtë është se sistemi i plotëson nevojat aktuale. Janë parë disa probleme të dizajnit në sistem, dhe për këtë ZAP dhe MF-ja janë pajtuar. ZAP ka identifikuar një numër çështjes për sa i përket mënyrës së si është përdorur sistemi dhe përdorimi i sistemit krahasuar me buxhetin për vitin 2011 me vitin 2012, është zhvilluar shumë. ZAP është munduar të identifikojë se kush është përgjegjës për çka. Dhe sigurisht kur Ministri e shpjegojë këtë, ai u mundua të shpjegojë se si kanë ndryshuar gjerat gjatë përgatitjeve të fundit të buxhetit. Dhe kjo nuk është për shkak të auditimit, por ky auditim i ka identifikuar disa çështje për ministrinë, që tashme veç kanë filluar të merren parasysh. Kjo gjithashtu është shumë pozitive. Raporti përmban rekomandime, së si duhet të zhvillohet sistemi dhe se si ministri duhet të luan një rol me aktiv sa i përket marrëdhënies me OB-të. ZAP ka marre parasysh komentet e MF –së dhe është munduar t'i qartësojë gjerat, por megjithatë në disa fusha ka nevojë për përmirësime. Ndau mendimin me ministrin që nuk ka obligim ligjor për të bërë analizat për projekte mbi 1 milion, por mendimi i ZAP-it është që Kuvendi për taksapaguesit duhet të përgatisë një raport të tillë. Kjo i bën gjerat me transparente. ZAP do ta përcjell këtë përsëri për të parë deri në çfarë shkalle janë implementuar rekomandimet.

Adem Grabovci – Tha se duhet të përsoset sistemi i menaxhimit të financave që është me shumë rëndësi e mbi të gjitha për Komisionin është shumë me rëndësi raporti që prodhohet nga ZAP-i, sepse pikërisht ZAP-i është institucioni që bënë vlerësim të mangësive. Mirëpo, duhet pasur kujdes, sepse në realitetin kosovarë është krijuar një perceptim negativ që nuk ka të bëjë me realitetin ekzistues. Ky realitet është më pozitiv se sa që është perceptimi. Këtë duhet ta ndërrojmë në një mënyrë të drejtë dhe dobësitë duhet luftuar në radhë të parë duke i identifikuar ato. Le të ballafaqohen argumentet, pastaj Komisioni do ta ketë më të lehtë. Ministri ofroj argumentet për ndryshime pozitive, pastaj këtë e tha edhe auditori i cili krahasoi vitin 2011 me 2012, ku sipas tij ka ndryshime pozitive.

Valbona Dibra – Raporti është sqarues për ata që nuk e njohin këtë lëmi. Përgëzoi ZAP-in për këtë. Po ashtu falënderoj ministrin për detajet sqaruese lidhur me këtë raport. Auditimi i sistemit, se si është dizajnuar ai sistem dhe si përdoret ai është një fushë e gjere dhe tani shtrohet pyetja: a ka staf ZAP që të bëjë një auditim të tillë duke ditur kapacitetet e ZAP-it. Për të bërë një auditim të tillë nevojitet staf i specializuar.

Armend Zemaj – Raporti nxjerr në pah të meta të mëdha dhe këto të meta nuk janë teknike, sepse ka të bëjë me parane publike, destinimin, mbrojtjen e saj dhe shpenzimin e saj zhvillimor. Zyra për planifikim strategjik dhe KIP-i nuk kanë arrite të përmbush kërkesat pavarësisht faktit që ka mangësi ligjore. Disa herë është cekur se komunat kanë probleme. Sipas raportit dorëzimi në MF i buxhetit të komunave është i pakompletuar. Mos-përfshirja e prioritetëve të OB-ve dhe mungesë e lidhjes në mes të projektit dhe prioritetëve të Qeverisë apo të sektorit përkatës. Kjo lidhet direkt me zhvillimin e këtij vendi. Hyrja në obligime pa fonde të mjaftueshme nuk donë koment, vetëm se len hapësirë për dyshime për korrupsion. Ndarja në kode apo përcjellja e shpenzimeve në total. Nuk është përmendur autostrada Vermicë - Mendare. Kjo është dashtë të ndahet në dy kode, ndërsa figuron vetëm në një kod. Monitorimi i projekteve duke përdorur PIP-in ka vend për përmirësim. Ligji thotë që çdo tre muaj duhet për të raportuar për raport të progresit, këtë nuk e përmendi ministri. Këto nuk janë gabime teknike, janë të gjetura dhe MF-ja e Qeveria duhet t'i pranoj ato. Nëse këto të gjetura nuk ekzistojnë atëherë përgjegjësinë duhet ta marrë auditori, sepse raporti flet për shumë të gjetura. P.sh e gjetura - pagesa e mjeteve për projekte që nuk janë të buxhetuara. Është fjala për dy projekte - e të cilave auditori nuk ju përmend emrin. Gjuha e përdorur në mes të auditorit dhe ministrit është e ashpër dhe për përmirësim të gjendjes duhet të ketë një koordinim të mirëfilltë që paraja publike të menaxhohet drejtë.

Murselj Haljili – Sipas raportit KIP nuk ka arrit që të shqyrtoj të gjitha projektet e mëdha publike. Pyeti: a ka kërkuar ZAP arsye se pse nuk e ka bërë këtë Komiteti? Cilat janë shkaqet, që nuk janë shqyrtuar projektet e mëdha publike? Kjo për faktin se në raport askund nuk përmenden shkaqet.

Ramiz Lladrovci – Komisioni trajton raportin e auditorit dhe të gjeturat e auditorit janë kundërshtuar në mënyrë të argumentuar nga ministri. Nga kjo del se ZAP-i nuk ka ekspert për auditimin në këtë lëmi. Komisioni përkrah punën e ZAP-it, por Komisioni mund edhe të mendoj ndryshe. Kërkoi nga auditori që të sqaroj të gjeturat, të cilat në mënyrë të argumentuar i bëri ministri, në mënyrë që Komisioni të ketë informacione të sakta dhe të mjaftueshme. Pyeti: a është bërë përmirësim i raportit pas komenteve të MF-it?

Agim Krasniqi, MF- Tha se prioritetet e Qeverisë janë ato që paraprijnë dhe zhvillohen përmes objektivave dhe në procesin buxhetor këto objektiva shndërrohen në aktivitete. Kjo nuk ka qenë e qartë për ZAP-in. Në asnjë pikë nuk guxon të përdoret keq-menaxhimi. Projekti për të cilin flet raporti ka qenë i planifikuar në vitin 2011 dhe ky projekt kur është tenderuar ka kushtuar më shumë se që është planifikuar. Në momentin kur nënshkruhet kontrata në vlerë më të madhe se që janë obligimet, në rastet e tilla sipas Ligjit të buxhetit projektet e tilla futen në vitin vijues. Raportet që janë për Thesar mbi 10 mijë euro, janë raporte më LMFP dhe LB neni 15. pika 3, këto raporte nuk guxon të përzihen me raporte të tjera. Këto raporte kanë për qëllim që për OB –të që hyjnë në obligime dhe nuk i kryejnë ato brenda 60 ditëve, atëherë Thesari nëse merr nga Gjyqësori konfirmimin zyrtar, ka të drejtë të bëjë ekzekutimin pa pyetur OB-të. E gjetura për monitorimin e projekteve mbi 1 milion euro- nuk ekziston, sepse ekziston vendimi me FMN-në që për të gjitha projektet mbi 400 mijë euro të raportohet, e kuptohet që edhe për projektet mbi 1 milion euro. Duhet pasur kujdes që të mos ngatërrohen sistemet. Sistemi i Thesarit duhet përdorur me patjetër, sepse është sistem i pagesave, ndërsa sistemi PIP dhe raportet e monitorimit janë çështje menaxheriale. Me qëllim të përmirësimit dhe monitorimit

më të mirë të projekteve kapitale është zbritur vlera nga 1 milion në 400 mijë dhe kjo nuk është gjetur siç është prezantuar nga ZAP-i. Në rast se projektet nuk zhvillohen sipas dinamikës ministri ka të drejtë që të lëvizë mjetet kjo sipas Ligjit. Pjesa më e madhe e të gjeturave është rregulluar me buxhetin e këtij viti. Funksionimi i Komitetit nuk është obligativ, por ministri e ka bërë me qëllimin më të mirë dhe mbi bazën e rekomandimeve të këtij Komiteti, ministri ka bërë rekomandime për kursime në vitin e kaluar. Janë mbajtur trajnime, mbi 400 zyrtarë janë trajnuar dhe të gjitha ministrive ju janë lëshuar udhëzimet se si duhet përdorur sistemi i PIP-it. Projekti Vërmicë - Merdare figuron në një kod – në Thesar vitin e kaluar është prezantuar projekti së bashku me shpronësimin, sepse ka qenë kërkesë e FMN-së.

Petrit Popova, Drejtor i Politikave dhe Buxheteve Komunale - Komentet për nivelin komunal janë dhënë me datë 5 mars. Fokusi i Zyrës ka qenë që gabimi teknik i lëshuar nga ZAP –i është përmirësuar dhe është përfshirë në raport. Disa pika të tjera janë përfshirë në raport, por nuk janë realiteti që ekziston në fakt. Janë vizituar 10 komuna plus tri komuna-flitet për vitin 2012 dhe thotë që duke ju janë referuar qarkores së buxhetit, dorëzimi i buxheteve komunale- është bërë një lëshim. Shkresa përcjellëse e buxhetit komunal ekziston, vendimi i KK ekziston duke përfshirë edhe komunat veriore- ku ekziston autorizimi i vendimmarrësve të komunës atje. Kjo nënkupton se dokumentacioni i komunave ekziston në ZPS. Ekzistojnë 5 tabela për komuna të cilat janë pjesë e buxhetit të miratuara në Kuvend. Pra 100% Buxheti 2012 në bazë të qarkores ekziston. Komunat ndërrojnë tabelat e buxhetit, kjo në bazë të reformës, dhe kjo nga tri programe apo sektor tani ka komunë që ka nga tri e më shumë sektor/departamente. Për secilën drejtori buxheti është i ndarë, stafi është i ndarë. Kategoritë ekonomike janë të specifikuara, ndërsa kualitetin i dokumentacionit mund të jetë i dobët.

Ruzhdi Halili ZPS,ZKM –Vlerësimi i ZPS-së përmes sistemit të PIP nuk është i mundur, sepse kjo Zyrë është pjesë e Komitetit të investimeve publike i cili Komitet funksionon vetëm në baza pilot. Zyra nuk lëshohet në nivel të projekteve, por vetëm në nivel të planifikimeve strategjike. Ka një plan strategjik i cili është i publikuar, por ekzistenca e këtij plani nuk figuron në raport. Korniza ligjore është kompletuar.

Kryetari – Buxheti është pjesë politike, por deri te një planifikim strategjik duhet të konsultohen edhe projektet.

Lars Lage OLOFSSON – Informoi Komisionin se nuk këtë rast nuk është një auditim i IT-së. ZAP ka audituar se si funksionon sistemi dhe për këtë ka kapacitete. ZAP është shumë i kënaqur me progresin që është bërë më pas. Por, gjatë kohës së auditimit kjo ka qenë situata aktuale.

Fitim Halili, auditor,ZAP - Është bërë vlerësimi i sistemit dhe me këtë është marrë stafi profesional. Kanë ekzistuar disa gabime teknike në përlllogaritje dhe bartësit programor janë pajtuar me ato gabime, të cilat tashmë nuk ekzistojnë. Por, atëherë kjo ka qenë evidente. Sa i përket raportimit të projekteve-thuhet se raportet duhet të jenë mbi 10mijëeuro - faktikisht ideja ka qenë që të jetë më fleksibilitet që të mund të nxirret raport mbi 1 milion euro. Tabela 4.2 duhet të ri-dizajnohet. Bartja e informatave në mes të sistemeve duhet të shqyrtohet mundësia që të bëhet në mënyrë automatike, e jo në mënyrë manuale. Sipas qarkores të gjitha komunat duhet të përdorin sistemin BDMS.

Adem Grabovci – Propozoi që raporti të mos procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

Armend Zemaj- Të gjeturat e ZAP-it nuk duhet arsyetuar si gabime teknike. Janë të gjetura shumë serioze të cilat duhet të korrespondojnë me ndryshim pozitiv. Për herë të parë është audituar kjo fushë dhe progresi do të përcillet në vitin tjetër. Këtë do ta bëjë personalisht përmes pyetjeve parlamentare, por edhe përmes KMFP-së.s

Ramzi Lladrovci – Tha se ZAP nuk ka përmirësuar raportin pas komenteve nga MF. Kjo për faktin se vet auditori e pranoi se ka përmirësime të mëdha.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

- *Raporti i Auditimit për Programin për Investime Publike(PIP), nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.*
- *Funksionimin e këtij sistemi, Komisioni do ta mbikëqyrë përmes raportit të radhës së auditimit.*

4. Të ndryshme

a). Diskutim Rreth raportit vjetor të Punës së OSHP-së dhe KRPP-së

Kryetari – Propozoi që Komisionin të shqyrtoj raportin vjetor të OSHP-së dhe KRPP-së pavarësisht që këto raporte i ka shqyrtuar Komisioni për Buxhet dhe Financa. Të dhënat flasin për të dhëna statistikore dhe jo për gjëra të detajizuara.

Ramiz Lladrovci – Tha se Komisioni shqyrton raportet e audituara dhe duhet pasur kujdes që të mos merret më informata të mediave apo të shtypit.

Armend Zemaj – Tha se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike mund t'i shqyrtoj këto raporte, mirëpo kjo është kompetencë e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ishte i mendimit që pasi që të vijnë raportet e auditorit për këto dy institucione, Komisioni pastaj do të dal me një qëndrim.

Propozoi që me kërkesë të veçantë Komisioni të kërkoj nga zëvendëskryeministrja znj.Edita Tahiri, raport financiar për udhëtimin në të cilin janë shpenzuar rreth 50 mijë euro- shumë kjo e përfolur- për vizitën e realizuar. Raporti duhet të përmbaj të dhënat për qëllimin e vizitës, nëse ka qenë mbikëqyrëse e asaj vizite dhe cila është baza ligjore e shpenzimit të atyre parave publike. Kjo në bazë të kompetencës së këtij Komisioni në këtë fazë.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

Kërkohet nga zëvendëskryeministrja e Republikës së Kosovës znj.Edita Tahiri, raport financiar për udhëtimin e realizuar në Shqipëri.

Mbledhja përfundoi në orën 15:40

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu